



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 222, Datë 23.10.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË
“HYDROPOWERPLANT CONSTRUCTION” SH.P.K. PËR MARRJEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET HIPOTEKIMIT) TË
ASETEVE FIKSE TË SAJ**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, gërma “a”, dhe 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 4, gërmat “a” dhe “b”, 6, 7 dhe 8 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.07.2016; nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2039/2 prot., datë 21.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROPOWERPLANT CONSTRUCTION” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “HYDROPOWERPLANT CONSTRUCTION” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Hurdhas 1” (1.71 MW), “Hurdhas 2” (1.3 MW) dhe “Hurdhas 3” (1.2 MW), me kapacitet total të instaluar 4.21 MW, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 94, datë 06.10.2014, modifikuar kjo me vendimin nr. 28 datë 15.02.2017. Kjo shoqëri është licencuar gjithashtu dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 102, datë 07.11.2014, modifikuar me vendimin nr. 29 datë 15.02.2017.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2039 prot., datë 04.10.2024, shoqëria ka paraqitur kërkesën për marrjen e miratimit nga ERE për transferimin e aseteve të luajtshme e të paluajtshme (nëpërmjet barrësimit/hipotekimit) të saj, për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredi dhënëse, Banka Amerikane e Investimeve sh.a.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 44, pika 2 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 2, gërma “a”, nenit 3, nenit 5, gërma “j” dhe nenit 6 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, ERE miraton kërkesat e të licensuarave për transferimin e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licensuar. Në këto rrethana për sa vlerësuar në lidhje me kërkesën e shoqërisë, ERE do të shprehet vetëm për asetet fikse të shoqërisë, pasi asetet e luajtshme nuk janë objekt shqyrtimi i kësaj rregullore.
- Nga shqyrtimi i aplikimit dhe në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit”, rezulton se shoqëria “HYDROPOWERPLANT CONSTRUCTION” sh.p.k., ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, për pikën 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “f” dhe “g”; pikën 4 dhe pikën 6.
- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

Neni 7

Pika 1

- **gërma “d”:** Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e kërkuar nga kjo pikë e rregullores në lidhje me kandidatin e propozuar (ABI Bank sh.a.) për transferimin e aseteve.
- **gërma “e”:** Shoqëria duhet të informojë në lidhje me shlyerjen e kësaj kredie si dhe garantimin e mbarëvajtjes së aktivitetit pas transferimit të aseteve.
- **gërma “h”:** Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE marrëveshjen përkatëse në lidhje me hipotekimin e aseteve për transferimin e të cilave kërkohet dhe miratimi ERE-s, ku të përshihet dhe të jetë pjesë përbërëse lista e detajuar e aseteve fikse, me vlerën individuale dhe totale.
- **gërma “i”:** Shoqëria duhet të depozitojë deklaratën përkatëse, siç kërkuar në këtë pikë të rregullores.
- **gërma “j”:** Shoqëria duhet të informojë ERE-n nëse ka pasur transferim të aseteve të kryera më herët.
- **Pika 3:** *(subjektet koncesionare të licensuar, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncesionit në pjesët që transferojnë tek përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e Autoritetit shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve.)* Në zbatim të kësaj pike të Rregullores nga shoqëria nuk është depozituar asnjë informacion/dokumentacion që informon Autoritetin Kontraktor. Megjithëse në kontratën e Koncesionit nr. 2807 Rep., nr. 371 Kol., datë 01.09.2009, të formës BOT” nuk është shprehur qartë detyrimi për të marrë pëlqimin/autorizimin e Autoritetit Kontraktor, do t’i kërkohet shoqërisë që në zbatim të neneve 8.1 dhe 17.3 të kontratës së koncesionit dhe në zbatim të rregullores, shoqëria të informojë/depozitojë në ERE, njoftimin/autorizimin e MIE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HYDROPOWERPLANT CONSTRUCTION” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të saj për të garantuar shlyerjen e detyrimeve ndaj palës kredidhënëse “BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE” sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “HYDROPOWERPLANT CONSTRUCTION” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI